



Esmeralda Kadëna Ph.D

Lektore
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
Tirana Business University College

Esmeralda Kadëna Ph.D., ka përfunduar studimet e doktoraturës me rezultate të shkëlqyera në fushën e sigurisë kibernetike pranë Shkollës Doktorale të Sigurisë në Universitetin e Óbudës, Hungari (2022). Ajo ka një përvojë 5-vjeçare si lektore dhe kërkuese shkencore në të njëjtin universitet, ku gjithashtu ka kontribuar si Ambasadore e Shqipërisë për kërkuesit shkencorë shqiptarë në Hungari gjatë periudhës 2021-2022.

Në vitin 2017-2018 ka shërbyer si këshilluese për studentët ndërkombëtarë në Universitetin e Óbudës, ndërsa që prej vitit 2019 është angazhuar si kërkuese shkencore në projekte që përfshijnë fusha si kontejnerët e të dhënave, digjitalizimi, robotika dhe siguria kibernetike. Esmeralda Kadëna Ph.D. ka punuar si lektore e ftuar në Fakultetin e Biznesit dhe Menaxhimit të Universitetit të Óbudës dhe më pas si lektore e brendshme në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Sigurisë.

Ajo ka drejtuar Departamentin e Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës në një universitet privat në Tiranë nga viti 2022 deri në 2024. Gjatë kësaj periudhe ka qenë lektore e ftuar edhe në disa universitete private në Shqipëri.

Aktualisht, Esmeralda Kadëna Ph.D. është pjesë e stafit akademik të TBU-së, duke drejtuar Departamentin e Inxhinierisë Softuerike. Ajo mbetet aktive në kërkimet shkencore dhe bashkëpunimet ndërkombëtare, duke shërbyer si koordinatore për zhvillimin e marrëdhënieve bashkëpunuese midis Universitetit të Óbudës dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë në Ballkan.

Përveç karrierës akademike, Esmeralda Kadëna Ph.D. ofron konsulencë për kompani ndërkombëtare mbi aspekte të sigurisë kibernetike dhe strategjive të sigurisë digjitale. Gjatë karrierës së saj, ajo ka publikuar disa artikuj në konferenca dhe revista shkencore ndërkombëtare.